



Pranimi / Dërgesa / Priljeva / Prodato / Received / Delivery	15.03.2022	2	viti / god / year
Organ / Njësia / Organ / Jedinica / Org. Unit	Mr Prot / Br Prot / Prot No	Shtesa / Pilog / Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity
SKAMSHICIL	1398/2022		117



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.131/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje: Malësore Gashi Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton koca-anëtarë si dhe Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit duke u bazuar në Aktgjykimin me numër A.nr.1581/2020 të datës 14.02.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.191/2020 të datës 14.07.2020 të parashtruar nga ankuesi [redacted] me adresë rruga [redacted] kundër Vendimit me numër 02-12356 të datës 19.06.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Kamenicës, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 15.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** pjesërishtë si e bazuar ankesa me numër A.nr.191/2020 e datës 14.07.2020 e parashtruar nga ankuesi [redacted]
- II. **SHFUQIZOHET** Vendimi i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me numër 02-12356 i datës 18.06.2020 si dhe Vendimi me numër 02/ 6098 i datës 28.02.2020 i Komisionit Disiplinor i Komunës së Kamenicës.
- III. **MBETET në fuqi** Vërejtja me shkrim me numer protokollit 37444 e datës 03.12.2019 e shqiptuar nga Ushtruesja e Detyrës së Drejtores së Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Kamenicës
- IV. **OBLIGOHET** Menaxheri i Personelit, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të tij, duke bërë shuarjen e masës disiplinore nga dosja personale e ankuesit të shqiptuar me datë 28.02.2020.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.



## Arsy e t i m

Ndaj ankuesit [redacted] i punësuar në Komunën e Kamenicës sipas Akt Emërimit të datës 01.02.2016, në vendin e punës "Zyrtar i Arsimit të Mesëm të Lartë", në Drejtorinë e Arsimit, me datë 03.12.2019 Ushtruesja e Detyrës së Drejtores së Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Kamenicës i ka shqiptuar masën disiplinore „Vërejtje me shkrim“ për shkak të shkeljes së parimeve të përcaktuara në Rregulloren 04/2015 për Kodin e Mirësjelljes në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Po ashtu me datën 05.12.2019 Ushtruesja e Detyrës së Drejtores së Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Kamenicës parashtron kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore, për nëpunësin civil [redacted] për shkak të shkeljeve të supozuara të rënda të detyrave të punës.

Komisioni Disiplinor i Komunës së Kamenicës, me datë 28.02.2020 nxjerr Vendim me numër 02/6098, me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore "Largim nga zyra dhe transferim në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalim i gradimit deri në pesë (5) vjetë nga komisioni disiplinor".

Ankuesi i pakënaqur me vendimin e Komisionit Disiplinor të Komunës së Kamenicës me numër 02/6098 të datës 28.02.2020, më datën 12.03.2020 me numër 02/7622 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Kamenicës.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Kamenicës më datë 19.06.2020 ka nxjerr Vendim me numër 02/12356, me të cilin vendim e ka refuzuar ankesën e ankuesit duke vërtetuar vendimin e Komisionit Disiplinor.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me numër Nr.02/12356 të datës 19.06.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Kamenicës, me datë 14.07.2020 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 1357/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 15.07.2020, me numër protokoll 1377/2020 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Kamenicës, ndërsa me datën 24.08.2020 me numër protokoll 1604/2020, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Kamenicës, me shkresat e bashkangjitura.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 26.08.2020, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi, ka ndjekur procedurat e tjera administrative duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 04.02.2022 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.1581/2020 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e



Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 26.08.2020, duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e ankuesit të datës 14.07.2020.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:** Ankesën me Nr. Prot:1357/2020 të datës 14.07.2020 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktgjykim nga Gjykata Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative me numër A.nr.1581/2020 i datës 14.02.2022; Njoftim i datës 26.08.2020; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 15.07.2020; Konkurs nga Drejtoria Komunale e Arsimit me numër 30113 i datës 27.09.2019; Vendim për formimin e komisionit përzgjedhës me numër 33948 i datës 25.10.2019; Vendim për formimin e komisionit përzgjedhës me numër 35607 i datës 11.11.2019; Vendim për formimin e komisionit përzgjedhës me numër 37681 i datës 04.12.2019; Njoftim me numër 37945 i datës 06.12.2019; Njoftim me numër 38394 i datës 11.12.2019; E-mail nga XH.B. për M.H. i datës 26.11.2019; E-mail nga M.M. për XH.B. i datës 26.11.2019; E-mail nga XH.B. për M.M. i datës 26.11.2019; Vërejtje me shkrim me numër 04/37444 i datës 03.12.2019; E-mail nga XH.B. për A.H. i datës 05.02.2020; Shkresë nga Ordinanca Specialistike Jeta i datës 03.02.2020; Vendim me numër 02/36901 i datës 26.11.2019; E-mail nga F.K. për XH.B. i datës 13.07.2020; Vendim i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Kamenicës me numër 02/12356 i datës 19.06.2020; Vendim i Komisionit Disiplinor i Komunës së Kamenicës me numër 02/6098 i datës 28.02.2020; Përgjigje në ankesë i datës 24.08.2020; Akt Emërimi i XH.B. i datës 01.02.2016; Aprovi.mi nga sistemi SIMBNJ i datës 19.11.2015; E-mail nga A.J. për D.S. i datës 11.12.2019; E-mail nga A.J. për XH.B. i datës 13.12.2019; Raporti i një shkelje disiplinore të supozuar i datës 05.12.2019; Ankesë drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Kamenicës me numër 02/7622 i datës 12.03.2020; Vërtetim i pranimi vendimit të datës 19.06.2020; Procesverbal i Komisionit Disiplinor me Nr.08/2019 i datës 07.02.2020; E-mail nga B.K. për C.Z. i datës 08.03.2022; E-mail nga C.Z. për B.K. i datës 08.03.2022; E-mail nga B.R. për M.M. i datës 03.12.2019; Pliko me numër 02/17997 i datës 20.08.2020; E-mail nga C.Z. për B.K. i datës 10.03.2022; Procesverbal i Komisionit Disiplinor me nr.08/2019 i datës 13.02.2020; Procesverbal i Komisionit Disiplinor me nr.08/2019 i datës 12.02.2020; Procesverbal i Komisionit Disiplinor me nr.08/2019 i datës 07.02.2020; E-mail nga B.K. për C.Z. i datës 11.03.2022; E-mail nga C.Z. për B.K. i datës 11.03.2022; Fletëkthesë e datës 07.09.2020; Fletëkthesë e datës 20.07.2020; Pliko me nr. R9010316 i datës 21.07.2020;

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është*  
*pjesërisht e bazuar, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar dëshmitë e ofruara nga ankuesi dhe organi i punësimit respektivisht komunikimet përmes e-mailit dhe konkretisht e-mailin e datës 26.11.2019 ndërmjet ankuesit dhe udhëheqëses të drejtpërdrejtë të tij lidhur me Vendimin me numër numër protokolli 04/35607 te dates 11.11.2019 te U.D. të Drejtores se Drejtorisë Komunale të arsimit per caktimin e ankuesit ne cilësinë e Kryesuesit te Komisionit Përzgjedhës për vlerësimin e kandidateve ne konkursin e shpallur te datës 27.09.2019 nga Drejtoria Komunale e arsimit për pozitën e lirë „Mbështetës profesional në lëndën e matematikes” dhe ka konstatuar se ankuesi po atë ditë përmes e-mailit ka kërkuar sqarime nga Drejtoresha se pasiqë



konkursi është shpallur me date 27.09.2019 pse Komisioni i mëparshëm nuk e ka kryer punën e tij dhe njëkohësisht ka shprehur shqetësimin e tij lidhur me presionin që po ushtron udhëheqësja e tij e drejtpërdrejtë lidhur me atë se në këtë konkurs të pranohet një kandidat me përgatitje të mesme shkollore, po ashtu ai e ka njoftuar drejtoreshën se si Komision nuk mund të vepojmë' sepse Vendimi me numër numër protokoll 04/35607 i dates 11.11.2019 është në kundërshtim me Udhëzimin administrativ (MPMS) 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në sektorin Publik, sepse është jashtë afateve kohore. U.D. të Drejtores së Drejtorisë Komunale të Arsimit, me të njejeten date i ka kthyer email dhe ka kërkuar sqarim nga ankuesi se pasi që emaili ju drejtohet tre personave, nuk e ka të qartë se ke e akuzoni për presion, kurse ankuesi i përgjigjet se „Drejtoreshë juve personalisht ju akuzova për presion , për fat të keq nuk është hera e parë që ju me bëni presion dhe për këtë kam dëshmi“

Më datën 03.12.2019, Ushtruesja e Detyrës së Drejtorit të Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Kamenices ankuesit [redacted] i ka shqiptuar „Vërejtje me shkrim“ për shkak të shkeljes së parimeve të përcaktuara në Rregulloren 04/2015 për Kodin e Mirësjelljes në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenit 5, paragrafi 1: *Nëpunësit civil në punën e tyre udhëhiqen nga parimi i pavarësisë profesionale, integritetit personal, përgjegjshmërisë dhe ndershmërisë*, për shkak të deklaratave të tij të pavërteta për presion të ushtruar ndaj tij nga ana e Drejtoreshës së Arsimit e që të njëjtën gjë ia ka përcjellë përmes komunikimit në e-mail zyrtar duke shkelur parimet e mirësjelljes të renditura si më lartë. Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton që në bazë të nenit 5 të Rregullores (QRK) - Nr. 04/2015 për Kodin e Mirësjelljes në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës është përcaktuar mirësjellja e nëpunësve civile si dhe parimet themelore të cilat nëpunësit civil gjatë ushtrimit të detyrave të tyre janë të obliguar t'iu përmbahen, në këtë rast deklaratat të pavërteta për presion të ushtruar, gjegjësisht pa i dëshmuar me dëshmi konkrete ndaj eporeve dhe stafit përbën shkelje të dispozitave legjislacionit për shërbimin civil, andaj masa disiplinore „Vërejtje me shkrim“ e shqiptuar nga udhëheqësja e drejtpërdrejtë për ankuesin është në pajtim me dispozitat e nenit 66 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *„Masat disiplinore zbatohen në mënyrë graduale dhe në proporcion me pasojat dhe dëmet e shkaktuara nga sjellja e nëpunësit civil“* dhe Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil.

Po ashtu Ushtruesja e Detyrës së Drejtorit të Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Kamenices më datë 05.12.2019 parshtron inicimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit nën dyshimin e bazuar se ankuesi ka bërë shkelje të rëndë të detyrave dhe përgjegjësi të punës, sipas nenit 6, paragrafi 1.10, 1.15 dhe 1.16, të Rregullores 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, për shkak të e-mailit në adresë zyrtare të dërguar nga Brikenë Ramabaja, Drejtoreshë e Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme, me këtë përmbajtje: „Më datë 26.11.2019, Xhemail Berisha erdhi në zyrën time me njoftoj që vajza e tij ka konkuruar në konkursin që është hap për psikolog të shkollave ma kërkoi ti ndihmoj vajzës që të pranohet të flas me Drejtoreshën Mirhane, ai më njoftoi se është caktuar në një komision për mbështetës profesional në lëndën e matematikës dhe kusht për të kryer punën në këtë komision është ti pranohet vajza në konkursin për psikolog të shkollës. Ai ka kërkuar që me këtë kusht unë ta njoftoj Drejtoreshën Mirhane“, konkreteisht për shkak të akuzimit për presion dhe kushtezim nga ana e ankuesit për Drejtoreshën.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të dëshmive të ofruara në lëndë, ka konstatuar Ushtruesja e Detyrës së Drejtorit të Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Kamenices dy dite pas shqiptimit të masës disiplinore ndaj ankuesit „vërejtje me shkrim“ me datën



05.12.2019, ka iniciuar procedurë disiplinore ndaj ankuesit [redacted] nën dyshimin e bazuar se ankuesi me veprimin e tij ka kryer shkelje të rëndë të detyrave dhe përgjegjësive të punës, sipas nenit 6, paragrafi 1.10, 1.15 dhe 1.16, të Rregullores 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil,, respektivisht me arsyetimin e njëjtë për shkak të deklaratave të tij të pavërteta për presion dhe kuzhtëzim të ushtruar ndaj tij nga ana e Drejtoreshës së Arsimit e që të njëjtën gjë ia ka përcjellë përmes komunikimit në e-mail zyrtar me date 26.11.2019, ndërsa Komisioni Disiplinor i Komunës së Kamenices, më datë 28.02.2020 nxjerr Vendim, me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore *"Largim nga zyra dhe transferim në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalim i gradimit deri në pesë (5) vjetë nga komisioni disiplinor"*, për shkak se me veprimin e tij ankuesi ka kryer shkelje të rëndë të detyrave dhe përgjegjësive të punës sipas nenit 6, paragrafi 1.10, 1.15 dhe 1.16, të Rregullores 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Komunës së Kamenices, me rastin e nxjerrjes së vendimit me numër Vendim me numër 02/6098, të datës 28.02.2020, me të cilin i ka shqiptuar ankuesit masën disiplinore *"Largim nga zyra dhe transferim në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalim i gradimit deri në pesë (5) vjetë nga komisioni disiplinor"* ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore që përcaktojnë procedurën disiplinore dhe masat disiplinore për nëpunësit civil sepse me dispozitat e Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil nenit 11 paragrafin 2, 3 dhe 5 dhe 12 paragrafin 1 dhe 2 janë përcaktuar kompetencat e Udhëheqësit të drejtpërdrejtë apo Udhëheqësit me të lartë administrativ të institucionit si në vijim : 2 *"Udhëheqësi i drejtpërdrejtë ose udhëheqësi më i lartë administrativ identifikon detajet e shkeljes dhe vendos se shkelja disiplinore është e natyrës së parëndësishme, shkelje e lehtë apo e rëndë- serioze"* si dhe ,, Nëse Udhëheqësi i drejtpërdrejtë konstaton se shkelja mund të cilësohet si shkelje e rëndë- serioze , ne afat prej dy (2) dite pune do ta paraqes rastin me shkrim të Udhëheqësi i Njësisë së personelit'' ,, Pas marrjes së njoftimit, Udhëheqësi i Njësisë së personelit, shkeljen e dyshuar ia kalon për shqyrtim komisionit disiplinor të institucionit përkatës'', ndërsa me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149. Për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenin 71 paragrafin 1 nën paragrafin, si dhe nenin 13 të Rregullores Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, janë përcaktuar kompetencat e Komisionit Disiplinor, si në vijim: ,,1. Komisioni disiplinor ka këto kompetenca: 1.1. të dëgjojë provat lidhur me shkeljen e supozuar; 1.2. të vendosë, në bazë të provave, nëse është kryer shkelja; dhe 1.3. përcakton dënimin që duhet shqiptuar'', sepse në këtë rast në provat e lëndës nuk kemi asnjë dëshmi që udhëheqësi i drejtpërdrejt i ankuesit të ketë ftuar ankuesin për të biseduar lidhur me rastin pas lajmërimit të shkeljes së supozuar siç përcaktohet dispozitat e nenit 11 paragrafin 3 të Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil po ashtu Komisioni nuk ka shqyrtuar në mënyrë të drejtë provat dhe faktet, gjegjësisht nuk ka marrë për bazë deklarin e ankuesit të dhënat e ofruara dhe dokumentet e bashkangjitura nga ankuesi.

Po ashtu, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Komisioni Disiplinor masën e ka shqiptuar në kundërshtim me nenin 67 paragrafin 1 nënparagrafin 1.2 pikën 1.2.3, të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe në kundërshtim me nenin 8 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, sepse Komisioni Disiplinor ka dështuar që të caktoj kohëzgjatjen e masës disiplinore, pasi që ka dhënë masën *"...deri në pesë (5) vjetë"*, dhe nuk ka përcaktuar afatin e saktë të kohëzgjatjes, duke lënë kështu të hapur periudhën e mosgradimit, e që është në kundërshtim me dispozitën e ligjit.



Me dispozitat e nenit 67 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe nenit 8 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, kjo masë disiplinore është përcaktuar „*largimi nga zyra dhe transferimi në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalimi i gradimit deri në pesë (5) vjet nga komisioni disiplinor*”; duke e lënë në diskrecionin e komisionit disiplinor që në varësi të shkeljes dhe provave të bashkëngjitura të përcaktoj saktë periudhën e masës disiplinore brenda afatit maksimal prej 5 viteve, andaj Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar dosjen e lëndës, ka konstatuar se masa e shqiptuar nga Komisioni Disiplinor nuk është shqiptuar në pajtim me dispozitat e legjislacionit për shërbimin civil.

Kolegji po ashtu ka konstatuar se ndaj ankuesit për të njëjtin supozim të shkeljes i është shqiptuar një masë disiplinore “vërejtje me shkrim”, nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë me date 03.12.2019 andaj mbi bazë të kësaj Komisioni Disiplinor i Komunës së Kamenices, me rastin e shqiptimit të masës disiplinore ka vepruar në kundërshtim me dispozitat Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, meqenëse Komisioni Disiplinor i ka shqiptuar ankuesit masën disiplinore për të njëjtën rrethanë që i është shqiptuar një masë tjetër brenda një afati kohor prej dy muajve, andaj Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se Vendimi me numër 02/6098, i datës 28.02.2020, i Komisionit Disiplinor i Komunës së Kamenicës është i paligjshëm dhe është në kundërshtim të plotë me nenin 52 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3, 1.5 dhe 1.7 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Meqenëse Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Vendimi me numër 02/6098, i datës 28.02.2020, i Komisionit Disiplinor i Komunës së Kamenices është i paligjshëm, atëherë Kryetari i Komunës së Kamenices dhe Menaxheri i Personelit, janë të obliguar që të bëjnë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke bërë shuarjen e masës disiplinore nga dosja personale e ankuesit .

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, po ashtu ka konstatuar se Vendimi me numër 02/12356 i datës 19.06.2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Kamenicës, është nxjerrë në kundërshtim me nenin 84, 85 dhe 86 të Ligjit Nr.02/L-28 për Procedurën Administrative, sepse ka dështuar të eliminoj shkeljet e bëra në procedurën disiplinore, me ç’rat ka vendosur në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi shqyrtoi gjithë procedurën disiplinore ka konstatuar gjithashtu, se ankuesi ankesën në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në Komunën e Kamenicës e ka parashtruar më datë 12.03.2020, ndërsa Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Komunës së Kamenicës, Vendimin me numër 02/12356, e ka nxjerr më datë 19.06.2020, jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 9 paragrafi 7 të Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave i cili përcakton se: “*Komisioni duhet të merr vendim brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e pranimit të ankesës*” si dhe në kundërshtim me nenin 135 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: “*Përpos kur ligji parashih një afat të ndryshëm, akti administrativ që zgjidh ankesën do të nxirret dhe njoftohet palës brenda tridhjetë (30) ditëve nga*



parashtrimi i ankesës”, andaj mbi këtë bazë Kolegji ka konstatuar ky vendim është i paligjshëm dhe shfuqizohet ashtu siç përcaktohet me Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 ku theksohet se: “Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative ”dhe si i tillë një akt i paligjshëm nuk duhet të prodhoj efekte juridike në dëm të ankuesit”.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamentin për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
**Lënda me numër A.nr.131/2022**

Clirim Zeka

Procesmbajtës

Malsore GASHI/BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Kamenicës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Kamenicës,
- Arkivit të KPMSHCK-së.

